



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNİ PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

Anr.360/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Hajriz Hoti kryesues, Bujar Muzaqi, dhe Ramush Bardiqi anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Organizata Joqeveritare CEL Kosova dhe Dylberizm me seli në Prishtinë, të paraqitur kundër Subjekti Politik, Koalicioni Për Familje me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës që do të mbahen më datë;09.02.2025, në seancën e panelit të mbajtur më datë; 07.02.2025, merr këtë:

V E N D I M

Refuzohet e pabazuar ankesa Anr.360/2025 e datës 04.02.2025, e parashtruar nga Organizata Joqeveritare CEL Kosova dhe Dylberizm me seli në Prishtinë, paraqitur kundër Subjektit Koalicioni Për Familje me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës që do të mbahen më datë 09.02.2025.

A r s y e t i m

Me datë 04.02.2025, PZAP-i, ka pranuar një ankesë nga Organizata Joqeveritare CEL Kosova dhe Dylberizm me seli në Prishtinë, më të cilën pretendohet se më 03 shkurt 2025, ora 19:13, gjatë fushatës zgjedhore të subjektit politik Koalicioni për Familje në qytetin e Podujevës, ngjarje e cila më pas është postuar në rrjetin social Facebook, janë bërë deklarata të cilat përmbajnë gjuhë nxitëse dhe stigmatizuese ndaj komunitetit LGBTI+, duke shkelur standardet ligjore dhe etike të përcaktuara nga Kodi i Mirësjelljes për subjektet politike, mbështetësit e tyre dhe kandidatët. Deklaratat janë bërë nga kandidatët për deputet të këtij subjekti, z. Eman Rrahmani dhe z. Fatmir Smajli, dhe përfshijnë elemente që nxisin urrejtje dhe stigmatizim të drejtpërdrejtë ndaj një komuniteti të caktuar. Po ashtu me një video tjetër, të publikuar në po të njëjtën datë në faqen e subjektit politik, Koalicioni për Familje e ka shkelur Kodin e Mirësjelljes duke i ekspozuar fëmijët në kuadër të fushatës zgjedhore.

kundërshtim me Kodin e Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, përkatësisht nenit 34 par.1 pika 1.11 të LZP-së. Kjo pasi që këto deklarime në asnjë rast nuk janë drejtur ndaj një subjekti, apo komuniteti të caktuar dhe nuk ka pasur thirrje apo nxitje për të ndërmarrë veprime kundër këtyre subjekteve të caktuara.

Andaj duke u mbështetur në nenin 117.3 të LZP-së ku përcaktohet se: *“Vendosja për ankesat nga PZAP-i mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse”*, Paneli vlerësoj se pretendimet e tilla janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj, për faktin se nga veprimet e përshkruara në ankesë dhe nga mos ofrimi i asnjë provë apo dëshmie parashtruesi i ankesës nuk ka arritur që të vërtetoj se ka pasur ndonjë parregullsi, pasi që ankesa e parashtruesit ka qenë sipërfaqësore dhe jo e konkretizuar, dhe si të tillë të njëjtën e refuzoi si të pabazuar.

Paneli në kuptim të nenit 117.3 dhe nenit 118 par.1 të LZP-së, Paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
A.nr.360/2025, datë: 07.02.2025

Kryesues i Panelit
Arsim Hamzaj



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

Anr.360-2/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Arsim Hamzaj - kryesues, Skender Çoçaj e Kymete Kicaj - anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Organizata Joqeveritare CEL Kosova dhe Dylberizm me seli në Prishtinë, të paraqitur kundër Subjekti Politik, Koalicioni për Familje, me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës që do të mbahen më datë 09.02.2025, në seancën e panelit të mbajtur më datë; 08.02.2025, merr këtë:

A K T V E N D I M

KORIGJOHET vendimi i PZAP Anr.360/2025, i datës 07.02.2025. ashtu që në hyrje të këtij vendimi, përkatësisht ku janë shënuar emrat e anëtarëve të panelit: Hajriz Hoti kryesues, Bujar Muzaqi dhe Ramush Bardiqi anëtarë, duhet të jetë "**Arsim Hamzaj - kryesues, Skender Çoçaj, dhe Kymete Kicaj - anëtarë**",

Në pjesët tjera vendimi në fialë mbetet i pandryshuar.

Ky vendim është pjesë përbërëse e vendimit Anr.360/2025, të datës 07.02.2025.

A r s y e t i m

Me datë 04.02.2025, PZAP-i, ka pranuar një ankesë nga Organizata Joqeveritare CEL Kosova dhe Dylberizm me seli në Prishtinë, andaj duke vepruar sipas kësaj ankese ka nxjerrë vendimin Anr.230/2025, të datës 07.02.2025, me të cilin e ka refuzuar ankesën e palës ankuese, duke vendosur më detajisht si në dispozitivit të këtij vendimi.

Paneli pas shqyrtimit të shkresave të lëndës sipas detyrës zyrtare ka konstatuar se në hyrje të vendimit të lartcekur është lëshuar gabim teknik, pasi që është bërë gabim lidhur me emrat e anëtarëve të panelit.

Andaj, PZAP bëri korigjimin e vendimit Anr.360/2025, të datës 07.02.2025, dhe atë në hyrje të këtij vendimi, përkatësisht ku janë shënuar emrat e anëtarëve të panelit: Hajriz Hoti

kryesues, Bujar Muzaqi dhe Ramush Bardiqi anëtarë, duhet të jetë **"Arsim Hamzaj - kryesues, Skender Çoçaj, dhe Kymete Kicaj - anëtarë "**,

Kopjet e vendimit i dërgohen sekretariatit për ekspedim palëve.

Nga sa u tha më lartë e konform dispoziteë se nenit 165 të LPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi, pasi që është bërë gabim teknik gjatë përpilimit të vendimit të lartcekur.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

A.nr.360-2/2025, datë: 08.02.2025

Kryesues i Panelit

Arsim Hamzaj



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së.